

V E N D I M
PER
RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 14/09/2002 une Gjyqtarja Mulla Cafa e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga Drejtori i Shoqerise "F.K.APOLLONIA" Sh.A. Fier, per rregjistrimin e saj si shoqeri tregetare

K O N S T A T O V A :

1. **z. Koço Kokedhima**
2. **Bashkia e qytetit Fier, e perfaqsuar prej kryetarit te saj z. Nikollaq KOSHOVARI** me cilesine e aksionereve te shoqerise "F.K.APOLLONIA" sh.a., kane vendosur themelimin e shoqerise anonime "F.K.APOLLONIA" sh.a. Kapital themeltar i shoqerise eshte 10 000 000 (dhjete milione) leke, i ndare ne 10 000 (dhjete mije) aksione me vlere nominale 1000 leke secila te shlyera ne masen 25% nga aksioneret e siperpermendur dhe te zoteruara perkatesisht nga:

1. **z. Koço Kokedhima i cili zoteron 75 (shtatedhjete e pese) % te aksioneve**
2. **Bashkia e qytetit Fier, e perfaqsuar prej kryetarit te saj z. Nikollaq KOSHOVARI e cila zoteron 25 (njezetepese) % te aksioneve**

Shoqeria "F.K. APOLLONIA" SH.A. do te kete si objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e pronesine te plote dhe ekskluzive mbi teresine e elementeve te:
Klubit te futbollit "APOLONIA" Fier
Skuadres se pare te futbollit "APOLONIA" Fier
Ekipeve zinxhir te moshave te ndryshme te krijuara prane ketij klubi
Emrit dhe Stemes se skuadres se futbollit "APOLONIA"
Ne menyre te vecante si objekt te veprimtarise se saj shoqerija do te kete administrimin dhe drejtimin e aktivitetit te skuadres se futbollit "APOLONIA" Fier.
Ajo do te kryej gjithashtu c' do lloj aktiviteti apo operacion financiar e juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi i cili do ti sjell perfitime shoqerise.
Shoqeria do te kete si objekt te saj in edhe formimin e ekipeve zinxhire te moshave te ndryshme si dhe krijimin e nje shkolle futbollit te specializuar, marketingun e te drejtes radio-televizive brenda dhe jashte vendit, menaxhimin e hapesirave publicitare si dhe menaxhimin e lojtareve brenda dhe jashte vendit duke respektuar rregullat e vendosura per kete qellim nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Lagja "16 Prilli" Fier.**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Drejtor i shoqerise eshte **z. Ermal Kaçurri.**

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja e Aksionereve jane:

- 1 **Endri PUKA** me cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres te **"F.K. APOLLONIA" SH.A.**
- 2 **Bashkim TUFA**

Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte z. **Ethem SULA.**

Dokumentacioni i paraqitur nga kerkuesi eshte i plote, kerkesa e bazuar ne ligj dhe si te tilla duhen pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",si dhe te ligjit Nr. 7638,date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",

V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime **"F.K. APOLLONIA" SH.A.** te themeluar nga:

1. **z. Koço Kokedhima zoteron 75 (shtatedhjete e pese) % te aksioneve**
2. **Bashkia e qytetit Fier, e perfaqsuar prej kryetarit te saj z. Nikollaq KOSHOVARI zoteron 25 (njetepese) % te aksioneve**

Kapital themeltar i shoqerise eshte 10 000 000 (dhjete milione) leke, i ndare ne 10 000 (dhjete mije) aksione me vlere nominale 1000 leke secila te shlyera ne masen 25% nga aksioneret e siperpermendur.

Shoqeria **"F.K. APOLLONIA" SH.A.** do te kete si objekt te veprimtarise se saj ushtrimin e pronesine te plote dhe ekskluzive mbi teresine e elementeve te:

Klubit te futbollit **"APOLONIA" Fier**

Skuadres se pare te futbollit **"APOLONIA" Fier**

Ekipeve zinxhir te moshave te ndryshme te krijuara prane ketij klubi

Emrit dhe Stemes se skuadres se futbollit **"APOLONIA"**

Ne menyre te vecante si objekt te veprimtarise se saj shoqerija do te kete administrimin dhe drejtimin e aktivitetit te skuadres se futbollit **"APOLONIA" Fier.**

Ajo do te kryej gjithashtu c' do lloj aktiviteti apo operacion financiar e juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi i cili do ti sjell perfitime shoqerise.

Shoqeria do te kete si objekt te saj in edhe formimin e ekipeve zinxhire te moshave te ndryshme si dhe krijimin e nje shkolle futbollit te specializuar, marketingun e te drejtes radio-televizive brenda dhe jashte vendit, menaxhimin e hapesirave publicitare si dhe menaxhimin e lojtareve brenda dhe jashte vendit duke respektuar rregullat e vendosura per kete qellim nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Lagja "16 Prilli" Fier.**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Drejtor i shoqerise eshte z. **Ermal Kaçurri**.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja e Aksionereve jane:

- 1 **Endri PUKA** me cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres te "F.K. APOLLONIA" SH.A.
- 2 **Bashkim TUFA**

Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte z. **Ethem SULA**.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Tirane me: 14/09/2002

GJYQTARE


AKT - THEMELIMI
I
SHOQERISE ANONIME "F.K.APOLLONIA" SH.A.



Ne Fier sot ne daten ~~02/09~~ 2002. te meposhtmit:

1. **Koço KOKEDHIMA**, i biri i Theodhoriut, lindur ne Qeparo me 21.04.1959, banues ne Tirane ne adresen: Rr. "Muhamet Gjolllesha". Pall. 68; qe zoteron 75 (shtatedhjetepese) % te kapitalit themeltar te sh.a. "F.K.APOLLONIA"
2. Bashkia e qytetit Fier. e perfaqshuar ne kete akt themelimi prej kryetarit te saj z. Nikollaq KOSHOVARI i biri i Jozgjit, lindur ne Fier me 9/8/1944 banues ne adresen J. D. N. ... qe zoteron 25 (njezetepese) % te kapitalit fillestar.

si themelues te kesaj Shoqerie Anonime, ne te cilen ata jane aksionere, vendosen te hartojne kete **Akt Themelimi**, mbeshtetur ne parimet e meposhtme:

Neni 1

Themeluesit krijojne nje Shoqeri Anonime, te cilen do ta quajne "F.K. APOLLONIA" sh.a.

Shoqeria do te kete formen e shoqerise anonime pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri anonime me oferte publike.

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare", nga ligji nr 8650, date 28.07.2000 " Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr. 8114, date 28.03.1996 " Per Sportin" nga ky statut, dhe nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Emertimi i plote i shoqerise eshte "F.K. APOLLONIA" SH.A. Te gjitha aktet e nxjerra nga shoqeria do te pasohen nga ky emertim.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Lagja "16 Prilli" Fier.**

Ajo mund te transferohet ne çdo vend tjeter me nje vendim te Keshillit Mbikqyres. me kusht qe ky vendim te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se Aksionereve.

Neni 4

Kohezgjatësia e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar te veprimtarise se saj, por jo me shkurtes se 10 vjet, duke filluar qe nga momenti i regjistrimit te saj ne Rregjistrin



Tregetar, me perjashtim te rasteve kur shoqeria mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionereve.

Neni 5

Shoqeria "F.K. APOLLONIA" SH.A. do te kete si objekt te veprimtarise se saj ushtimin e pronesine te plote dhe ekskluzive mbi teresine e elementeve te:

Klubit te futbollit "APOLONIA" Fier

Skuadres se pare te futbollit "APOLONIA" Fier

Ekipeve zinxhir te moshave te ndryshme te krijuara prane ketij klubi

Emrit dhe Stemes se skuadres se futbollit "APOLONIA"

Ne menyre te vecante si objekt te veprimtarise se saj shoqerija do te kete administrimin dhe drejtimin e aktivitetit te skuadres se futbollit "APOLONIA" Fier.

Ajo do te kryej gjithashtu e' do lloj aktiviteti apo operacion financiar e juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi i cili do ti sjell perfitime shoqerise.

Shoqeria do te kete si objekt te saj in edhe formimin e ekipeve zinxhire te moshave te ndryshme si dhe krijimin e nje shkolle futbollit te specializuar, marketingun e te drejtes radio-televizive brenda dhe jashte vendit, menaxhimin e hapësirave publicitare si dhe menaxhimin e lojtareve brenda dhe jashte vendit duke respektuar rregullat e vendosura per kete qellim nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Neni 6

Kapital themeltar i shoqerise eshte 10.000.000 (dhjetemilione) Leke, i ndare ne 10,000 (dhjetemije) aksione me vlere nominale 1.000 (njemije) leke secili, te numeruara nga 1 (nje) ne 10.000 (dhjetemije) perfshi dhe numrin e fundit te shlyera ne masen 25% nga aksioneret e siperpermendur. Ky kapital eshte i vlefshem per rregjistrimin e shoqerise. Shlyerja e pjeses se mbetur te kapitalit do te kryhet me nje ose disa keste sipas vendimit te drejtorise por jo me vone se 1 (nje) vit nga data e rregjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Kapitali realizohet prej kontributit total te aksionerit Koço KOKEDHIMA i cili i akordon Bashkise se qytetit Fier 25% te aksioneve kundrejt perdorimit te emrit dhe stemes se ekipit te futbollit "APOLONIA". Me krijimin e shoqerise Bashkia nuk do te kete te drejte ta terheqi nga shoqeria emrin dhe steme e klubit te futbollit. Elementet e mesiperm ne asnje rast nuk mund te nxirren ne likuidim, ne raste te falimentimit apo likuidimit te shoqerise. Ne nje rast te tille emri dhe stema rikthehen ne pronesine ekskluzive te Bashkise se Qytetit Fier.

Neni 7

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. 2 (dy) prej tyre jane emeruar nga Asambleja Themeluese e Aksionereve. Ata jane:



Anetari i trete ne Keshillin Mbikqyres do te zgjidhen nga te punesuarit ne shoqeri konform dispozitave te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Presidenti i pare i Klubit te Futbollit "APOLONIA" eshte z. **Koço KOKEDHIMA**

Kryetar i Keshillit te pare Mbikqyres eshte z. **Endri PUKA**.

Drejtori i pare i shoqerise anonime "F.K. APOLLONIA" sh.a. eshte z. **Ermal KAÇURRI**.

Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte z. **Ethem SULA**.

Neni 8

Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar, ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

Neni 9

Shoqeria anonime "F.K. APOLLONIA" sh.a. fillon veprimtarine e saj me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

THEMELUESIT

KOÇO KOKEDHIMA



**PER BASHKINE E QYTETIT FIER
KRYETARI
NIKOLLAQ KOSHOVARI**

